



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:
Hasim Krasniqi	17.03.2021	19.03.2021	240/21

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.03.2021, OE "Pharma Leader" L.L.C - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 240/21 kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Meditech sh.p.k", Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Insulina Analoge nga Lista Esenciale" për Lot 1 dhe 3, me nr. të prokurimit: 206-20-8397-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 7,024,056.00 €.

Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE Ankesa 240/21

Dispozitat e shkelura sipas, OE "Pharma Leader" L.L.C - Prishtinë, e cila ka parashtruar ankesë me nr: 240/21, janë

Neni 1, i LPP-së,
Neni 6, i LPP-së
Neni 7, i LPP-së,
Neni 59, i LPP-së,
Nenin 60, i LPP-së,
Nenin 69, i LPP-së,

pikat e ankesës:

OE ankuese ka parashtruar ankes lidhur me arsyjen e eliminimit të saj nga AK që nderlidhen me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht kërkeses qe nderlidhen me deshmit respektivisht rreth mos plotësimit të 2. Kërket regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02 2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës. si dhe pretendimin se AK nuk e ka respektuar kriterin kryesor për dhënie te kontrates, e që ka qenë tenderi i pëgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 paragrafi 1.1 sepse në krahasim me oferten e OE te rekomanduar për kontratë ne kemi ofertuar me çmim më të lirë rreth 400,000.00 € për Lot 1 dhe 3

-Per me teper referojnu deklarates ne ankesen e paraqitur pran OSHP-se nga ana e operatorit ankues nr.240/21.

Demet materiale

Neve si operator ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesë për rishqyrtim në vlerë prej 5000.00 euro.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta me pretendimet e parashtruara nga OE me kërkesen për rishqyrtim në AK.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.4) Kërkesat-Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 2. Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02 2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 2. Autorizimi për Marketing ne Kosovë, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë vlenë UA 02 2014 dhe per dëshmi - Kopja e Certifikatës se Autorizim Marketingut ne një vend te BE (si dëshmi se produkti qarkullon ne BE).

IV.2) KRITERET E DHËNIES

Çmimi më i ulët

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE"Pharma Leader"L.L.C - Prishtinë, sipas raportit te vlersimit dhe letres standarte per eliminim Autoriteti Kontraktue ka eliminuar OE ankuese për këtë arsye **nuk e kanë plotësuar :**

2. Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02 2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës.

Komisioni i vlerësimit ka rekomanduar ZP që me kontratë të shpërblehet OE: **"Meditech sh.p.k"., Prishtinë,** me çmim me te lirë në vlerë prej: LOT 1: 1, 144, 726.72 dhe LOT 3: 4, 456, 908.24 €.

Menaxheri i prokurimit, ka aprovuar rekomandimin e komisionit të vlerësimit.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Qasja ne dokumentacionet te cilat gjenden në platformen e e-prokurimit që janë publikuar dhe shtuar nga AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe dokumentacionet e bashkangjitura nga operatorët ekonomik pjesmarres në këtë aktivitet të prokurimit.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

Duke u bazuar në shkresat e lëndës, mendoj se operatori ekonomik ankues është palë interesi në këtë aktivitet të prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "Pharma Leader" L.L.C - Prishtinë – Ankesa 240/21

Duke u mbështetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatohet me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7 dhe 59 të LPP-së, me arsyetimin se:

“OE ankuese ka parashtruar ankes lidhur me arsyjen e eliminimit të saj nga AK që nderlidhen me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht kërkeses që nderlidhen me dëshmit respektivisht rreth mos plotësimit të 2. Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar të produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02 2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Republikën e Kosovës..”

duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës ekspertit shqyrtues konstaton se AK ka eliminuar OE ankuese me arsyetimin se nuk e ka plotësuar:

2. Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar të produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02 2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Republikën e Kosovës.

ndersa AK në njoftimin për kontratë dhe në FTD të dosjes se tenderit ka parashtruar kërkesën dhe dëshmit si vijon:

Kërkesa:

Kërkesa 2. Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar të produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02 2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Republikën e Kosovës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 2. Autorizimi për Marketing në Kosovë, me specifikimin e kërkuar të produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë vlenë UA 02/2014 dhe për dëshmi - Kopja e Certifikatës së Autorizim Marketingut në një vend të BE (si dëshmi se produkti qarkullon në BE).

Ndërsa, OE ankuese së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar :

1. "Autorizim Letter" të leshuar nga kompania "Eli Lilly Export S.A" me seli në Gjenevë, Zvicër , me datën 17.12.2020 me të cilën është autorizuar kompania "Forma Trejd d.o.o.e.l" me seli në Shkup, Maqedoni që të marr pjesë në aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Insulina Analoge nga Lista Esenciale" për Lot 1 dhe 3, me nr. të prokurimit: 206-20-8397-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, për produktet LOT 1: Humalog Kwikpen 100U/ML 3ML XSPEND dhe për LOT 3: Humalog Mix25 Kwikpen 100U/ML XSPEND
2. "Autorizim Letter" të leshuar nga kompania "Forma Trejd d.o.o.e.l" me seli në Shkup, Maqedoni , me datën 18.12.2020 me të cilën është autorizuar kompania "Pharma Leader" L.L.C, që të marr pjesë në aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Insulina Analoge nga Lista Esenciale", me nr. të prokurimit: 206-20-8397-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.
3. Deklaratën e përfaqësuesve të kompanisë "Eli Lilly Export S.A" dhe marrëveshjen e lidhur në mes kompanisë "Eli Lilly Export S.A" me seli në Gjenevë, Zvicër dhe kompanisë "Forma Trejd d.o.o.e.l" me seli në Shkup, Maqedoni, për pjesëmarrje në aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Insulina Analoge nga Lista Esenciale", me nr. të prokurimit: 206-20-8397-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.
4. Deklaratën e "Pharma Leader" L.L.C, të leshuar me dt.05.01.2021 me të cilën kanë bashkangjitur dëshmitë e regjistrimit të produkteve: 1. Humalog Kwikpen 100 IU/ml.sol për inj.Pen i parambushur (EU/1/96/007/031), 2. Humalog Mix25 Kwikpen 100 IU/ml.sol për inj.Pen i parambushur (EU/1/96/007/033), si dhe,
5. Në fajlat me numër rendor 4, 5 dhe 6 të ofertes së OE ankuese të cilat gjenden në platformën e E-prokurimit, janë bashkangjitur: Lista e autorizimeve EMA për produktet e insulente Humalog, të dhënat dhe specifikat për kodet A10ABO4 dhe A10ADO4 të cilat kodet në bazë të shënimeve i referohen produkteve Humalog Kwikpen 100 IU/ml.sol dhe Humalog Mix25 Kwikpen 100 IU/ml.sol.

Po ashtu me ankesën e dorëzuar në OSHP, OE ankuese ka bashkangjitur e-mailat e datës 03 dhe 05.02.2021,

në bazë të cilëve konstatohet komunikimi në mes zyrtarit të prokurimit të Ministris së Shendetësis z. Besim Bajraktari dhe zyrtares së importit në Agjencia e Kosovës Për Produktet dhe Paisjet Medicinale znj.Fikrije Hoti e cila ka konfirmuar për zyrtarin e prokurimit të Ministris së Shendetësis se “*ju lejohet importi i produktit me ATC code A10ABO4 dhe A10ADO4 ne baze te UA 02/2014 pasi qe ndryshon niveli i fundit i kodit ATC me produktet qe jane te regjistruara*” si dhe sqarimet e leshuara nga OBSH lidhur me ATC code A10ABO4 dhe A10ADO4 , bazuar në faktet e cekura më lartë, eksperti shqyrtues mendon se OE ankuese ka dorëzuar dëshmi të mjaftushme konform kërkesës “*Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02 2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës*” të cilën e ka parashtruar AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Përkunder kësaj nëse AK edhe më tutje ka ndonjë dyshim rreth autorizimeve dhe dëshmive të bashkangjitura nga OE ankuese nderlidhur me produktet e ofertuara atëher me rastin e vlerësimit ka mundur respektivisht mundet që konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkojë sqarime nga kompanit të cilat i kanë lëshuar autorizimet dhe dëshmit tjera si dhe nga AKKPM-ja, për ti vërtetuar dëshmit e bashkangjitura nga OE ankuese. Andaj pretendimi i lartë cekur i OE ankuese është pjesrisht i bazuar.

Po ashtu eksperti shqyrtues konstaton se në paragrafin e parë të faqes 6 të Vendimit e dates 12.03.2021 me të cilin AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankuese ka potencuar si vijon: “Pjesa e parë e kriterit te tenderit është “Kërkohet regjistrimi i barit-autorizimi për marketing nga AKPPM” ku prioritet kanë produktet që janë të regjistruara ne Republikën e Kosovës, krahasuar me produktet qe nuk janë të regjistruara.”, eksperti shqyrtues mendon se ky sqarim i dhën nga AK në vendimin e dates 12.03.2021 me të cilin kanë refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankuese, është në kundërshtim me kërkesën dhe dëshmin e parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit sepse AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka parashtruar:

Kërkesa 2. Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02 2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës.

.dhe

Dëshmia 2. Autorizimi për Marketing ne Kosovë, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë vlenë UA 02/2014 dhe per dëshmi - Kopja e Certifikatës se

Autorizim Marketingut ne një vend te BE (si dëshmi se produkti qarkullon ne BE).

Nga kërkesa dhe dëshmia e cekur më lartë shihet se AK askund nuk e ka cekur se prioritet kanë produktet që janë të regjistruara ne Republiken e Kosovës, krahasuar me produktet qe nuk janë të regjistruara siç e kanë potencuar në vendimin e dates 12.03.2021 me të cilin kanë refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankuese, ky veprim i AK është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së ku thuhet: “*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*”.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 60 të LPP-së me arsytimin se: “*AK nuk e ka respektuar kriterin kryesor për dhënie te kontrates, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 paragrafi 1.1 sepse në krahasim me oferten e OE te rekomanduar për kontratë ne kemi ofertuar me çmim më të lirë rreth 400,000.00 € për Lot 1 dhe 3*” duke u bazuar në përgjigjet e pretendimeve te cekuar më lartë dhe faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankuese **është pjesrisht i bazuar** sepse operatori ekonomik ankues ka dorëzuar ofertë financiare në vlerë prej: LOT 1: 1,097,467.36 € dhe LOT 3: 4,109,006.12 € ndersa OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë financiare në vlerë prej: LOT 1: 1, 144, 726.72 dhe LOT 3: 4, 456, 908.24 €, dhe nese krahasohen këto oferta financiare, atëher konstatohet se **oferta e OE ankuese është me e lirë në vlerë të përbashkët për LOT 1 dhe 3, prej 395,156.48 €, se sa oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë**. Mirëpo për kunder kësaj AK, me rastin e vlerësimit të ofertave konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së, së pari duhet të vlerësoj dhe konstatoj se cilet nga operoret ekonomik pjesmarres në këtë aktivitet të prokurimit i plotësojnë kërkesat e parashtruara nga vetë AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe janë të përgjegjshëm administrativisht, e pasi që të konstatoj përgjegjshmerin administrativ te OE pjesmarrese atëher duhet ta zbatoj kriterin “çmimi më i lirë” të parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, respektivisht të veproj konformë paragrafit 1.1 te pikes 1 te nenit 60 të LPP-së ku thuhet se: “*Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët*”.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimet e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 69 të LPP-së, duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues **nuk është i bazuar** sepse OE ankuese pretendimin në fjale vetëm e ka cekur sipërfaqsisht pa sqaruar dhe pa dhënë ndonjë fakt rreth shkeljes së këtij neni në deklaratën e ankesës së dorëzuar, po ashtu me nenin 69 të LPP-së rregullohen respektivisht udhëzohen autoritetet kontraktuese se si mund të kërkojnë dhe vendosin në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë kërkesat minimale si dhe cilat dëshmi duhet të kërkojnë-dorëzohen nga OE lidhur me aftësit teknike dhe/ose profesionale, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **aprovohet si pjesërisht e bazuar**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- | | |
|---------------------------|---|
| - Autoritetit Kontraktues | - Ministria e Shëndetësisë. |
| - Panelit Shqyrtues | - OSHP. |
| - OE ankues | - "Pharma Leader" L.L.C - Prishtinë. |